

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

21 Gusht, 2020

Përshëndetje Familjarë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Eshtë e vështirë të besosh që jemi më pak se dy javë larg nga fillimi i asaj që me siguri do të jetë një vit shkollor i paparë 2020-2021. Ndërsa ky vit shkollor do të duket dhe do të ndjehet shumë ndryshe pasi ndërmarrim hapa për të mbështetur mirëqenien e të gjithëve gjatë pandemisë COVID-19, një gjë që mbetet e njëjtë është entuziazmi ynë për të mirëpritur studentët tanë përsëri për një vit tjetër shkollor.


Për shumë muaj ne kemi qenë duke punuar shumë për t'u përgatitur për vitin e ri shkollor që fillon të Mërkurën, 2 Shtator për të gjithë nxënësit nga PreK-12, i cili për periudhën e parë të vitit shkollor do të jetë mësim dixhital. Ne jemi:

- duke përdorur njohuri dhe reagime nga pranvera e kaluar për të forcuar mënyrën se si mësuesit do të japin mësim dhe fëmijët do të mësojnë në mënyrë virtuale;
- angazhimin e drejtorëve dhe personelit të tjerë të shkollës për mbledhje profesionale në mënyrë që të mbështesim më mirë nevojat e nxënësve dhe familjeve tona. Këto mbledhje fillojnë në 24 Gusht.
- zhvillimi i përkrahjeve emocionale sociale për studentët dhe personelin duke pranuar që së pari duhet t'i adresojmë këto nevoja si rezultat i traumave që kemi përjetuar të gjithë për shkak të pandemisë dhe padrejtësive raciale sistemike;
- ndërtimi i një Koalicioni të Barazisë për të ndihmuar në çrrënjosjen dhe zhdukjen e politikave dhe praktikave të pabarabarta ose raciste në shkollat dhe vendet e punës dhe të krijojmë të drejta të barabarta për të gjithë në Drejtorinë tonë
- duke u përgatitur për të zgjeruar shërbimet tona të shpërndarjes së vaktit të ushqimit në mënyrë që studentët të vazhdojnë të marrin ushqime ndërkohë që mësojnë nga distanca;
- edhe më shumë.

Ne kemi mbledhur gjithashtu disa këshilla nga [lista e "Family Back - to - School"](#) për t'ju ndihmuar ju dhe fëmijën tuaj të organizohen dhe përgatiten për një vit të suksesshëm shkollor. Nëse nuk keni filluar të merrni informacione për shkollën nga shkolla e fëmijës tuaj, së shpejti do të merrni. Qëllimi ynë është të sigurohemi që i keni të gjitha informacionet që ju nevojiten për të filluar vitin shkollor.

Faleminderit për fleksibilitetin dhe partneritetin tuaj ndërsa punojmë së bashku për të mbështetur një vit shkollor të sigurt dhe të suksesshëm 2020-2021 për të gjithë. Ne mezi presim t'ju shohim së shpejti!

Sinqerisht,

A handwritten signature in cursive script that reads "William R. Hite Jr." followed by a small flourish.

William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias